



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Maj, 2025

01-31 maj, 2025

**PËRMBAJTJA E
BULETINIT**

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit maj 2024 dhe 2025
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

**1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA
SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT MAJ
2025 DHE 2024**

Gjatë muajit maj 2025 janë raportuar **12,234 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(686.49 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2024 (13,820 raste ose Inc 775.48 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Influenca sezonale (ILI) me 6,063 raste ose 340.21/100,000 banorë, Diare akute me 4,452 raste ose 249.82/100,000 banorë, dhe ARI/ITPR me 995 raste ose 55.83 në 100,000 banorë (Tab.1).**

Gjatë muajit maj 2025 janë raportuar 6 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 5 raste me dg. Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me dg. Meningoencephalitis purulenta

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, MAJ 2025

Gjatë muajit maj 2025 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me numrin më të lartë, (shih Tabela 1)

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit maj 2025 në IKShPK janë raportuar 6,063 raste me ILI (Inc. 340.21/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 12.61 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (6,938 raste) por krahasuar me muajin paraprak, prill 2025 me (8,739 raste të raportuara me ILI) vërehet ulje prej 30.62%, karakteristike kjo për sezonën dhe uljen e aktivitetit të qarkullimit të patogjenëve respirator.

Diarea akute: Gjatë muajit maj 2025 në IKShPK janë raportuar 4,452 raste me diare akute (Inc.249.82/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (4,835 raste), vërehet një ulje prej 7.92% por krahasuar me muajin prill 2025, me 4,000 raste të raportuara, rritje prej 11.3%. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë.

ARI/ITPR: Gjatë muajit maj 2025 në IKShPK janë raportuar 995 raste me ARI (Inc.55.83/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,240 raste) vërehet ulje prej 19.75% e numrit të rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak prill 2025 me (3,301 raste), ulje e konsiderueshme prej 69/85%.

Variçella: Gjatë muajit maj 2025 në IKShPK janë raportuar 398 raste me Variçellë (Inc.22.33/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (539 raste) vërehet ulje prej 26.15% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak prill 2025 numër i njëjtë i rasteve të raportuara.

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve të raportuara në Kosovë, 01 – 31 maj të vitit 2024 dhe 2025

Tabela 1.

Numri i rasteve dhe incidenca e disa sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve në Kosovë në periudhën 01 - 31 maj të vitit 2024 dhe 2025				
Sëmundjet /shkaktarët	Maj, 2024		Maj, 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100.000	Nr.	Incidenca/100.000
COVID-19	5	0.28		0.00
ITPR - Pneumonia/ARI	1240	69.58	995	55.83
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	9	0.51	15	0.84
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	6938	389.31	6063	340.21
Influenca A	3	0.17		0.00
Influenca B	5	0.28		0.00
RSV	5	0.28	5	0.28
Diarea acute	4835	271.31	4452	249.82
Variçela	539	30.24	398	22.33
Sindromi meningjeal	12	0.67	5	0.28
EHSV	1	0.06		0.00
Helmimet me ushqim	104	5.84	37	2.08
E.coli			3	0.17
Rota virus		0.00	2	0.11
Salmonella enteritidis	2	0.11	5	0.28
Enterovirus		0.00	1	0.06
Gastroenterokolitet	36	2.02	121	6.79
Hepatiti akut A		0.00	1	0.06
Hepatiti akut B	3	0.17	1	0.06
Hepatiti akut C		0.00	1	0.06
Morbilli	1	0.06	23	1.29
Parotiti epidemik	2	0.11	3	0.17
Pertussis	34	1.91	1	0.06
Tularemia	2	0.11	1	0.06
Brucelosis	3	0.17	1	0.06
Echinococcus	1	0.06	1	0.06
Malarie**	1	0.06		0.00
Sëmundja Lyme	1	0.06	2	0.11
TB		0.00	21	1.18
HIV/AIDS	1	0.06	4	0.22
IST	18	1.01	31	1.74
Cl.difficile	1	0.06	2	0.11
Giardiaza	2	0.11	5	0.28
Askariaza		0.00		0.00
*Sëmundjet tjera ngjitëse	16	0.90	34	1.91
Gjithsej	13820	775.48	12234	686.49
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Scarletina, Herpes zoster, Erysipella, Mykozat, Mononucleoza				
**Malarie-rast i importuar				

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:**Sëmundjet vaksinëpreventabile:**

Nga data 05.05.2025 deri me 31.05.2025 në IKShPK, është vërejtur një rritje e ndjeshme e rasteve të raportuara me fruth. Gjatë kësaj periudhe gjithsej janë raportuar 23 raste të dyshimta/të mundshme dhe të konfirmuara me fruth. Nga të gjitha rastet e raportuara me fruth, 18 prej tyre janë identifikuar si raste index dhe 5 raste si kontakte të këtyre rasteve duke treguar një përhapje në komunitet. Të gjitha rastet e raportuara janë të pavaksinuara me vaksinën MMR. Komuna e Ferizajit paraqet përqendrimin më të lartë të rasteve (mbi gjysmën e rasteve totale), dhe 91.3% të rasteve vijnë nga institucionet parashkollore.

Shpërndarja sipas komunave: Ferizaj (12 raste), Fushë Kosovë (3 raste), Prishtinë (4 raste), Shtime (2 raste), Lipjan (1 rast) dhe Kaçanik (1). Sipas grup moshës: 1-2 vjeç (17 raste) që përbën 74% të rasteve, 3-5 vjeç (4 raste) dhe mbi 6 vjeç (2 raste).

Numri më i lartë i rasteve është në grup-moshën 1-2 vjeç, që reflekton shtyrjen e vaksinimit dhe mosrespektimin e kalendarit të vaksinimit nga ana e prindërve.

Gjatë muajit maj 2025, gjithashtu janë raportuar edhe 1 rast i konfirmuar me Pertussis si dhe 3 raste të dyshimta me Parotitis. Nga laboratorit mikrobiologjik i IKShPK-së nga gjithsej 123 raste të testuara si raste të dyshimta me Rubellë, nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise:

Gjatë muajit maj 2025, nga grupi i sëmundjeve zoonotike, janë raportuar me nga 1 rast: Brucellozë, Tularemi dhe Echinokokozë. Sipas komunave rasti me Brucellozë nga Malisheva dhe rasti me Tularemi nga Podujeva. Të dy rastet i përkasin gjinisë femërore. Sipas moshës rastet i takojnë grup-moshave: 60-69 vjeç (1 rast) dhe 10-19 vjeç (1 rast). Të dy rastet janë trajtuar në mënyrë ambulantore.

Sipas anketimi epidemiologjik: rastet janë sporadike, pa ndonjë lidhshmëri epidemiologjike. Rasti me Brucellozë është pasojë e kontaktit me kafshë (dele) dhe për rastin në fjalë janë informuar AUV me qëllim të ndërrmarjes së hapave të mëtejshme. Rasti me Echinokokozë, është nga komuna e Prizrenit, i gjinisë mashkullore dhe i takon grup moshës 70-79 vjeç.

Sëmundjet që barten përmes vektorëve - Gjatë muajit maj 2025, janë raportuar 2 raste me borreliozë, 1 rast nga komuna e Prishtinës dhe 1 rast nga komuna e Drenasit. Sipas gjinisë 1 rast i gjinisë femërore dhe 1 rast i gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës 1 rast i takon grup moshës 30-39 vjeç dhe 1 rast grup moshës 40-49 vjeç.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit maj, 2025 janë raportuar 5 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.28/100 000 banorë), prej tyre 2 raste me Meningjit akut viral, 3 raste me Meningoencephalitis akut purulenta. Ky numër i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me periudhën e vitit 2024, ku ishin të raportuara gjithsej 12 raste (prej tyre 11 raste me Meningjit akut viral dhe 1 rast me Meningjit bakterial). Sipas komunave, me nga 2 raste janë raportuar në komunën e Podujevës dhe Klinës, kurse 1 rast në komunën e Shtimes.

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK në LCS është izoluar vetëm tek një rast *Listeria Monocytogenes*.

Gjatë kësaj periudhe kohore është raportuar 1 rast i vdekjes me dg. Meningoencephalitis purulenta, nga komuna e Podujevës, 64 vjeç, i gjinisë mashkullore me sëmundje tjera përcjellëse.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit maj 2025, janë raportuar 121 raste me Gastroenterokolit dhe 37 raste me Helmim me ushqim (Tabela 1 dhe 2).

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar:

- 1) 5 raste me Salmonela Enteritidis prej të cilave sipas komunave janë: 4 raste Ferizaj dhe 1 rast Prishtinë. Sipas grup moshave 4 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 10-19 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 2 raste janë të gjinisë femërore dhe 3 raste të gjinisë mashkullore. (shih pjesën Epidemitë)
- 2) 2 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 1 rast Prishtinë dhe 1 rast Mitrovicë. Sipas grup moshave të dy rastet janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë të 2 rastet janë të gjinisë mashkullore.
- 3) 1 rast me Hepatit A, nga komuna e Prishtinës, i gjinisë mashkullore dhe i takon grup moshës 30-39 vjeç.
- 4) 2 rast me Clostridium difficile, prej të cilave sipas komunave janë: 1 rast Prishtinë dhe 1 rast Podujevë. Sipas grup moshave 1 rast i grup moshës 30-39 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 50-59 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë të 1 rast i gjinisë femërore dhe 1 raste i gjinisë mashkullore.
- 5) 1 rast me Enterobius vermicularis, nga komuna e Mitrovicës, e gjinisë femërore dhe i takon grup moshës 0-9 vjeç.

Përmes SMSN nga regjioni i Prishtinës janë raportuar: 171 raste me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (A09); 1 rast me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecifikuar (A04.8); 5 raste me dg. Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale - A04.9; 4 raste me dg. Salmonella (Salmonella spp.) (A02.0) dhe 1 rast me dg. Hepatiti A (virusi i hepatitit A), (B15).

Sëmundjet/Infeksionet respiratore dhe TB

Gjatë muajit maj 2025, nga qendrat sentinel janë testuar 174 mostra të dyshimta në Influcë dhe patogjenët tjerë respirator. Nga mostrat e testuara nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv me Infleuncë A dhe B. Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 5 (2.87%) mostra pozitive me RSV, 13 (7.47%) mostra pozitive në Human Adenovirus, 10 (5.74%) mostra pozitive në Human Rhinovirus, 4 (2.29%) mostra pozitive në Metapneumovirus dhe 2 (1.14%) mostra pozitive ne Parainfluenca Virus.

Mbikëqyrja me Influcë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC dhe OBSH për Influcë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike. Duke pasur parasysh mungesën e sezonalitetit të parashikueshëm të SARS-CoV-2 dhe potencialin për rritje të aktivitetit edhe gjatë muajve pranverorë dhe verorë, mbikqyrja aktive duhet të vazhdojë gjatë gjithë vitit, në përputhje me udhëzimet e ECDC dhe OBSH.

Intensiteti i Influcës Sezonale për muajin maj 2025 paraqitet në nivel të ulët të aktivitetit të qarkullimit. Gjatë këtij muaji nuk është raportuar asnjë rast pozitiv, duke reflektuar një rënie të konsiderueshme krahasuar me muajin e kaluar. Ky nivel i ulët i qarkullimit është në përputhje me tendencën sezonale të kësaj periudhe të vitit.

Rastet pozitive në virusin sincial (RSV) sipas komunave dhe grupmoshës : Prishtinë (1 rast), Fushë Kosovë (1 rast), Obiliq (1 rast), Shtime (1 rast) dhe Hani i Elezit (1 rast).

Sa i përket moshës, të gjitha rastet pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç. Të gjitha rastet pozitive me RSV janë të hospitalizuar në Klinikën Pediatrike.

Përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse janë raportuar gjithsej 177 raste me Influençë të shkaktuar nga viruset e paidentifikuar dhe Pneumonitë tjera bakterore

Gjatë muajit maj 2025, përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse, u raportuan gjithsej 15 raste me SARI. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influenca dhe RSV. Prej tyre asnjëri nuk rezultoi pozitiv në viruset e lartpërmendura.

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (3 raste), Prizren (3 raste), Mitrovicë (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Vushtrri, Skenderaj, Pejë, Fushë Kosovë, Podujevë, Kaçanik dhe Mamushë. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : mbi 65 vjeç (8 raste), 51-64 (4 raste), 35-50 (1 rast), 5-14 (1 rast) dhe 15-34 (1 rast). Sipas gjinisë, 9 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 6 gjinisë femërore. Gjatë muajit maj 2025, janë shënuar 5 raste të vdekjes nga SARI (CFR=33.3).

Në SMSN, gjatë muajit maj 2025 janë raportuar 21 raste me Tuberkuloz apo 1.17 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtinë (14 raste), Ferizaj dhe Lipjan me nga (3 raste) dhe komuna e Pejës me 1 rast. Prej 21 rasteve të raportuara, 19 (90.47%) janë raste pulmonare dhe forma ekstrapulmonare 2 (9.52%). Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht janë 9 raste (47.3%). Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 60-69 vjeç me 8 raste apo (38.1%), grup moshat 50-59 vjeç me 5 raste apo (23.8%), grup mosha 20-29 vjeç me 4 raste (19.01%), grup mosha 10-19 vjeç me 2 raste apo (9.52%) kurse grup moshat 30-39 vjeç dhe 40-49 vjeç me nga 1 rast apo (4.76%). Sipas gjinisë, rezulton se 71.4 % (15 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe gjinia femërore me 28.5 % (6 raste).

Rastet me HIV/AIDS/IST, maj 2025

Gjatë muajit maj 2025, janë raportuar 4 raste me HIV. Tri raste i takojnë gjinisë mashkullore (2 grup mosha 25-34 vjeç, 1 grup mosha 45-54 vjeç) dhe një rast gjinisë femërore (grup mosha 50+).

Dy raste janë nga popullata kyçe MSM. Një rast rrugën e transmisionit e ka heteroseksuale dhe për një rast nuk është e raportuar rruga e transmisionit.

Rastet janë nga komuna Pejë, Kamenicë, Gjilan dhe për një rast nuk është e raportuar komuna. Rastet e dërguara për konfirmim: dy nga Klinika Infektive, një CSGD dhe një QKTGj. Të gjitha rastet janë konfirmuar me Western blot në Departamentin e Mikrobiologjisë.

Dy raste janë anketuar dhe raportuar përmes SMSN nga Kl. Infektive, përderisa dy tjera akoma jo, sepse rastet në fjalë ende nuk janë lajmëruar në Klinikën Infektive për përcjellje të mëturjeshme dhe trajtim.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), maj 2025

Gjatë muajit maj 2025 janë raportuar gjithsej 31 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 10, Pejë 8, Prizren 4, Prishtinë 3, Gjakovë 2, Hani i Elezit 1, Mamushë 1, Istog 1 dhe Viti 1. Sipas diagnozës: Chlamydia 24 raste, Condyloma 4, Sifiliz 2 dhe Gonorreja 1 rast. Sipas gjinisë: 25 raste i takojnë gjinisë femërore (81%) dhe 6 raste gjinisë mashkullore (19%). Grup moshës 25-49 vjeç i takojnë 23 raste (74%), grup moshës 15-24 vjeç 6 raste (19%) dhe dy raste grup moshës 50+ (7%).

Me post elektronike janë raportuar 12 raste nga laboratorit privat në Ferizaj përmes QRShP Ferizaj.

Dy raste janë raportuar përmes SMSN në QRShP Prizren, dy raste tjera SMSN JONILAB SH.P.K. dhe një rast SMSN Cambridge Clinical Laboratories Sh.P.K. Një rast me letër (forma individuale e raportimit) nga QKMF-QM6 Prishtinë. Dy raste nga Gjakova janë raportuar me SMSN (EUROPEAN CLINIC SH.P.K. dhe Mikrolab) Dy raste me SMSN Klinika e Dermatovenerologjisë. Një rast me SMSN KI Infektive. Tetë raste me post elektronike lab. privat në Pejë përmes postës elektronike QRShP Pejë.

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C, maj, 2025

Gjatë muajit maj, 2025 është raportuar 1 rast me Hepatit akut B (Mb. o./100 000 banorë) dhe 1 rast me Hepatit akut C, 30 vjeç e gjinisë femërore nga Gjilani.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, maj 2025

Tabela 2.

Tabela 2. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, maj _2025																																	
SËMUNDJA	Pneumo nia/ARI	SARI	ILI	Diarrhea oe	Varicella	RSV	Sindroma meningjeale			**Morbill i	Parotitis epidemic a	Pertuss s	Hepatit A	Hepatit oe. B	Hepatit oe. C	Helmine t me ushqim	Gastroe nterokoh tet	Bruceloz a	Tularemi	Salmone lloza	E.coli	Rotaviru s	Borelioz a (Lyme Disease)	Enterovi sus	Echinoc occus	Cl.difficil e	IST	HIV	TB	Giardiaz a	Sëm.tjer a ngjitëse	Totali	
KOMUNA							Meningi t serosa	Meningo encephal it ac.	Meningo encephal itis muculent																								
DEÇAN	1		24	43	5																											73	
DRAGASH	34		35	65	0												2														1	137	
DRENAS	43		55	53	3												3						1									158	
F. KOSOVË	16	1	4	68	6	1				3		1					13														2	115	
FERIZAJ	13		287	212	31					12						21	6			4							10		3			599	
GJAKOVË	4		63	56	9						2					1					3						2			3		143	
GJILAN	23		382	371	43										1		5												1			826	
GRAÇANICË				0	0																											0	
H. IELEZIT			54	47	1	1																						1				104	
ISTOG	1		79	56	0												1											1				138	
JUNIK			27	1	0																											28	
KAÇANIK	1	1	13	30	9					1							3															58	
KAMENICË	0		381	122	0												1												1			505	
KLINË			136	112	42			2																								292	
KLOKOT																																0	
LEPOSAT																																0	
LIPJAN	1			0	0					1							2													3		7	
MALISHEVË	4		119	80	7												4	1														215	
MAMUSHË	2	1	4	1	11																							1			2	22	
MITROVICË	54	2	473	548	36						1						2					1		1							19	1137	
NOVIÇE E VERIUT				0	0																											0	
N. BËRDË			19	13	0																											32	
OBILIQ			32	33	5	1											1															72	
PARTESH																																0	
PEJË	17	1	653	347	17												3											8	1	1		1048	
PODUJEVË	10	1	286	130	9			1	1							6	6		1							1						452	
PRISHTINË	664	3	1753	945	85	1				4			1	1			36			1		1	1			1	3		14		2	3516	
PRIZREN	18	3	274	533	43											8	27								1			4			4	915	
RAHOVEC	0		17	22	1																											40	
RANILLUG																																0	
SHITËRPECË																																0	
SHTIME	32		290	60	6	1			1	2																						392	
SKËNDERAJ	1	1	16	66	3												1															88	
SUHAREKË	13		220	164	1											1	3															402	
VITI	13		366	242	21																						1					642	
VUSHTRRI	30	1	2	32	4												2											1				6	77
Z. POTOK	0																															0	
ZVEÇAN																																0	
RGU ILIRIANIT																																0	
PA ADRESË																													1			1	
TOTALI	995	15	6063	4452	398	5	2	1	2	23	3	1	1	1	1	37	121	1	1	5	3	2	2	1	1	2	31	4	21	5	34	12234	

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza


3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT MAJ 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga , diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë dhe rastet tjera të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit maj 2025

Tabela 3.

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	106
SARI	15
Hepatitis B	1
Sindroma meningjeale	5
Helmimet me ushqim	12
Diarea akute dhe gastroenterocolite	147
Status febrilis	9
Exanthema	9
Mononucleosis	5
Erysipela	12
Vulnus morsum viperi	5
Total	326



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT MAJ 2025

Epidemia kolektive në Jezerc- Ferizaj

Më 03 maj 2025, rreth orës 13:30, 12 persona kanë konsumuar ushqim në restorantin “N.N”, i cili ndodhet në fshatin Jezercë, Komuna e Ferizajt. Prej 12 personave që kanë konsumuar të njëjtin ushqim, 7 prej tyre kanë shfaqur simptoma, ndërsa 2 prej tyre janë hospitalizuar në Klinikën Infektive. Ushqimi i konsumuar përbëhej nga një kombinim mishi, përfshirë: mish pule, mish viçi, pleskavicë, qofte si dhe sallatë (marullë, domate dhe ullinj). Simptomat janë paraqitur të nesërmen më 04 maj 2025, në intervalin kohor 18:00 – 19:00 me kokë dhembje, vjellje, diarre ujore, marramendje, ethe, temperature.

Pacientet kanë kërkuar ndihmën e parë mjekësore më datë 05 maj 2025 në QKMF Obiliq dhe QKMF Prishtinë (“Te Qafa”), mirëpo pasi gjendja e tyre shëndetësore nuk është përmirësuar, të njëjtët referohen për në Klinikën Infektive për trajtim dhe evoluim të më tutjeshëm. Me datë 06.05.2025 e kanë vazhduar kontrollin në Klinikën Infektive por kanë refuzuar hospitalizimin dhe kanë vazhduar me tretman mjekësor në QMF-Dragodan.

Me datë 07.05.2025 janë hospitalizuar rreth orës 13.00 h, ku ka filluar tretmani mjekësor nga Klinika Infektive. Nga 90 klientë të ekspozuar, me simptoma gastrointestinale ishin 7 raste të cilët kanë kërkuar ndihmë mjekësore (shkallë sulmi 12.22%).

Në bashkëpunim me Inspektoratin sanitarë janë ndërmarrë këto masa: Inspektorati Sanitar së bashku me ekipin e QRSHP-IKSHPK Ferizaj ka vizituar me datë 08.05.2025 në ora 14:30, restorant “N.N.” Jezercë, me ç ‘rast janë marrë 8 mostra/strisho nga ambienti i kuzhinës, në enë, në tavolina të punës, në aparate të përgatitjes së ushqimit, si dhe nga uniformat dhe duart e kuzhinierëve, për vlerësimin e kushteve higjieniko-sanitare të cilat janë sjellë me datë 08.05.2025 në QRSHP-Ferizaj për analizë. Janë marrë mostrat për koprokulturë për analizë në laboratorin e Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive.

Rezultatet laboratorike:- Në Laboratorin e Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive të QKUK-së, mostrat e fecesit të marra nga rastet e hospitalizuara kanë rezultuar negativ në koprokulturë. Nga 8 strisho të marra në ambientet e punës, mjetet e punës, uniformat dhe duart e kuzhinierit, mostra nga duart e kuzhinieres ka rezultuar *Staphylococcus aureus*, *Enterococcus* spp.

Epidemia kolektive me Sallmonella Enteritidis në Greme- Ferizaj

Më datë 08.05.2025 Inspektorati Sanitar dhe IKSHPK informohen nga Klinika Infektive QKUK, për hospitalizimin e 4 (katër) pacientëve me dg. Gastroenterocolitis acuta, nga fshati Greme-Ferizaj. Gjatë vizitës në terren, kuptohet se gjatë drekës së shtuar në ceremoninë mortore ishin 120 pjesëmarrës të cilët konsumuan ushqimin e njejtë të përgatitur nga gjellëtorja "N.N." Ferizaj. Pjesëmarrësit kishin konsumuar ushqim: gullash me mish viçi, pire, supë, sallatë me lakër, domate, kastravec, havëll, në mjedis privat (në të pame) të sjellë nga gjellëtorja në fjalë. Ushqimi është konsumuar, duke filluar nga ora 12:00, të datës 05.05.2025 ndërsa simptomat kanë filluar pas 3 ore, në të njëjtën datë. Nga numri i përgjithshëm, 14 rasteve (shkallë sulmi 11.6%) iu shfaqën simptome gastrointestinale dhe kërkuan ndihmë mjekësore. Nga 14 raste me simptome vetëm 4 raste u hospitalizuan në Klinikën Infektive në QKUK, ndërsa të tjerët morën shërbime ambulatorike në Ferizaj. Të gjithë pacientët (14) kanë pasur simptoma si: temperaturë, ethe, barkëqitje, vjellje, fryrje barku dhe mundim. Sipas gjinisë: femra (3), mashkuj (1), grupmoshat e përfshira janë 10-19 vjeç. Sa i përket rasteve ambulatorie 5 raste i përketin grup-moshës 30 – 39 vjeç, 3 raste grup-moshës 40 – 49 vjeç dhe 2 raste grup-moshës 60 – 69 vjeç. Ndërsa sa i përket gjinisë 6 raste ishin të gjinisë mashkullore dhe 4 të gjinisë femërore. Në bashkëpunim me Inspektoratin sanitarë janë ndërmarrë këto masa: Inspektorati Sanitar së bashku me ekipin e IKSHPK-QRSHP Ferizaj ka vizituar me datë 08.05.2025 në ora 09:30, gjelltoeren në fjalë, me ç'rast janë marrë 10 mostra/strisho për vlerësimin e kushteve higjieniko- sanitare nga ambienti i kuzhinës, në enë, në tavolina të punës, në aparate të përgatitjes së ushqimit, si dhe nga uniformat dhe duart e kuzhinierëve, të cilat janë sjellë me datë 08.05.2025 në QRSHP-Ferizaj për analizë. Me urdhër të Inspektoratit Sanitar, me datë 08.05.2025, mbyllet gjellëtorja në fjalë. Rezultatet laboratorike- Në Laboratorin e Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive të QKUK-së, janë dërguar për analizë 4 mostra të fecesit të marra nga rastet e hospitalizuara dhe në të 4 mostrat është izoluar Sallmonella Enteritidis. Sa i përket strishove të marra në ambientet e lokalit, nga mjetet e punës, enët, aparatet dhe personeli prej 10 strishove vetëm tek prerësja e sallatës është izoluar Escherihia coli.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre.

Komunat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet përmes SMSN

Institucionet shëndetësore	Numri i rasteve
AMF Bradash	1
AMF Fushë Kosovës	16
BI.Nuhi Morina	1
Cambridge Clinical Laboratories Sh.P.K	1
EUROPEAN CLINIC SH.P.K.	1
JONILAB SH.P.K.	2
Klinika e Dermatovenerologjisë	2
Klinika e Pediatrisë	2
Klinika e Sëmundjeve Ngjitëse- Infektive	101
Lege Artis	2
Mikrolab	11
Njësia shëndetësore e burgut - Prishtinë	1
OSP-Joni-Malisheve	1
PROLAB Medical Center SH.P.K.	1
Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut	5
QKMF - Deçan	2
QKMF - Fushë Kosovë	41
QKMF - Gjakovë	45
QKMF - Glogoc	2
QKMF - Hani i Elezit	4
QKMF - Istog	3
QKMF - Kaçanik	9
QKMF - Klinë	6
QKMF - Malishevë	10
QKMF - Obiliq	69
QKMF - Podujevë	33
QKMF - Prizren	2
QKMF - Skenderaj	6
QKMF - Vushtrri	5
QMF - 1	7
QMF Gadime	1
QMF Krushë e Madhe	2
QMF Lluzhan	6
QMF Lum i Madh	1
QMF Malishevë	2
QMF Milloshevë	6
QMF Orize	9
QMF Ponosheci	19


QMF Rahoveci	30
QMF Ratkoc	7
QMF Rogovë	5
QMF-1	3
QMF-2 Lakuriq	12
QMF-Besi	2
QMF-IV	6
QMF-V	6
QMF-XI	4
Reparti i sëmundjeve infective	4
Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë	52
Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri	34
Gjithsej	603

Gjatë muajit maj 2025, përmes SMSN nga 50 institucione shëndetësore janë raportuar gjithsej 603 raste me sëmundje ngjitëse. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kanë raportuar edhe disa institucione private (shih tabelën 4.) Nga numri i gjithmbarshëm i numrit të rasteve të raportuara me SMSN krahasuar me ate me letër shprehur në përqindje është 4.9%.

6. COVID-19

Gjatë muajit maj 2025, janë testuar 361 mostra të dyshimta në SARS CoV-2 dhe prej tyre nuk është raportuar asnjë rast pozitiv. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 (5 raste pozitive të raportuara), vërehet një ulje

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, prill 2025



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, MAJ 2025

Klasifikimi i varianteve të SARS-CoV-2

Që nga përditësimi i fundit më 25 prill 2025, dhe që nga 28 maji 2025, NB.1.8.1 (pasardhësi XDV) u shtua si njëvariant nën monitorim (VUM). Të dhënat për vlerësimin e varianteve gjatë javëve të raportimit janë të disponueshme vetëm nga dy vende të BE-së/EEA-së. Prandaj, statistikat më poshtë përfaqësojnë vetëm një pjesë të kufizuar të BE-së/EEA-së. • Përqindjet mesatare të VOI dhe VUM në BE/EEA për javët 19-20, bazuar në dy vende raportuese, janë aktualisht:

• KP.3 32.8% (8.5%-57.1%), BA.2.86 19.1% (7.1%-31.0%), XEC 7.8% (7.1%-8.5%), LP.8.1 33.2% (21.4%-45.1%)

Transmetimi i ulët i SARS-CoV-2, raportimi i reduktuar dhe testimi i ulët në qendrat sentinel kanë ndikim në aftësinë e ECDC-së për të vlerësuar me saktësi situatën epidemiologjike, duke përfshirë qarkullimin e varianteve.

Popullsia e BE/EEA-së në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit (infeksion paraprak plus vaksinim/vaksina përforcuese), duke dhënë mbrojtje kundër formave të rënda të sëmundjes. Variantet që qarkullojnë aktualisht dhe që klasifikohen si VOI ose VUM nuk ka gjasa të shoqërohen me ndonjë rritje të ashpërsisë së infeksionit krahasuar me variantet që qarkullonin më parë, ose një ulje të efektivitetit të vaksinës kundër sëmundjes së rëndë. Megjithatë, individët e moshuar, ata me sëmundje shoqëruese dhe individët që nuk janë infektuar më parë mund të zhvillojnë simptoma të rënda nëse infektohen. Vaksinimi vazhdon të jetë masa e vetme mbrojtëse, me mbrojtje kundër sëmundjeve më të rënda, megjithëse ky efekt mbrojtës zbehet me kalimin e kohës. Vaksinimi i individëve me rrezik të lartë për rezultate të rënda (p.sh. të rriturit e moshuar) mbetet i rëndësishëm.

Hepatiti A - (BE) - 2024-2025

Disa vende në BE kanë vërejtur një rritje të rasteve të raportuara të gjenotipit 1B të hepatitit A. Në veçanti, Austria, Çekia dhe Hungaria kanë vërejtur më shumë raste të raportuara sesa pritej midis nëntorit 2024 dhe majit 2025. Rritja e infeksionit HAV prek kryesisht të rriturit që janë të pastrehë, njerëzit me varësi nga droga dhe njerëzit që jetojnë në kushte të këqija sanitare. Janë identifikuar dy grupe të lidhura gjenetikisht të HAV 1b (grupi a dhe grupi b).

Sipas vlerësimit të ECDC-së, shpërthimi ka të ngjarë të jetë nxitur nga transmetimi nga personi në person midis njerëzve që jetojnë në kushte të këqija higjienike.

Mungesa e strehimit, sëmundjet bashkëshoqëruese, varësia nga droga dhe alkooli vërehen midis rasteve të raportuara, duke e bërë grupin më vulnerabil ndaj sëmundjeve të rënda. Zinxhiri i transmetimit është në vazhdim dhe ka të ngjarë të ndodhin raste të reja. Në kontekstin e shpërthimeve aktuale, nëse është e mundur, rekomandohen programe të synuara të vaksinimit para ekspozimit kundër hepatitit A për popullatat e pavaksinuara që janë në rrezik më të lartë infeksioni, siç janë personat që injektojnë drogë ose personat që kanë mungesë strehimi. Gjithashtu, ofrimi i profilaksisë pas ekspozimit duke administruar vaksinën e hepatitit A, ose në rrethana të caktuara imunoglobulinat e hepatitit A, në përputhje me udhëzimet kombëtare për të parandaluar rastet sekondare.

Sëmundja autoktone e virusit chikungunya - Réunion dhe Mayotte, Francë, 2024–2025

Në gusht 2024, Franca raportoi rastin e parë autokton të virusit chikungunya në 10 vitet e fundit. Që nga fillimi i vitit dhe që nga 18 maji 2025, afër 51 000 raste të konfirmuara autoktone të chikungunya janë raportuar në Réunion. Që nga fillimi i shpërthimit, 12 vdekje tek individë mbi 70 vjeç me sëmundje bashkëshoqëruese u klasifikuan si të lidhura me chikungunya.

Autoritetet e Shëndetësisë kanë këshilluar vendimmarrësit publikë të vaksinonjë grupet që janë në rrezik më të lartë për sëmundje të rënda dhe profesionistët e kontrollit të vektorëve. Agjencia rajonale e shëndetit filloi një fushatë vaksinimi për

individët me përparësi më 7 prill. Më 26 prill 2025, Ministria Franceze e Shëndetësisë raportoi tre raste me efekte anësore pas vaksinimit kundër chikungunya me vaksinën Ixchiq në Reunion, përfshirë një vdekje. Si rezultat, autoritetet shëndetësore pezulluan vaksinimin e personave mbi 65 vjeç, me ose pa sëmundje bashkëshoqëruese, në pritje të një rivlerësimi të raportit rrezik/përfitim. Vaksinimi mbetet i hapur për personat e moshës 18-64 vjeç me sëmundje bashkëshoqëruese.

Më 7 maj 2025, Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) deklaroi se komiteti i sigurisë i agjencisë (PRAC) ka filluar një shqyrtim të vaksinës Ixchiq pas raportimeve të ngjarjeve të rënda anësore tek të rriturit e moshuar. Si një masë e përkohshme, ndërsa një shqyrtim i thelluar është duke u zhvilluar, Ixchiq nuk duhet të përdoret tek të rriturit e moshës 65 vjeç e lartë.

Më 26 mars 2025, një rast autokton i chikungunya u raportua në Mayotte. Që nga 18 maji 2025 (java 20), 326 raste të konfirmuara të sëmundjes janë raportuar në ishull. Për shkak të qarkullimit të intensifikuar të rasteve të fituara në vend të chikungunya, plani ka kaluar në fazën 2B për të kontrolluar shpërthimin dhe për t'u përgatitur më mirë për një fazë të mundshme epidemike.

Monitorimi i tubimeve masive - Haxhi - Mbretëria e Arabisë Saudite - 2025

Në vitin 2025, pelegrinazhi vjetor i Haxhit Islamik zhvillohet në Mbretërinë e Arabisë Saudite nga 4 deri më 9 qershor. ECDC po e monitoron këtë ngjarje përmes inteligjencës së saj epidemike për aktivitetet e tubimeve masive midis 26 majit dhe 13 qershorit 2025 në bashkëpunim me CDC-në e Gjirit. Raportimi javor është parashikuar në Raportin e Kërcënimeve të Sëmundjeve Ngjitëse (CDTR), si dhe raportimi ad hoc në rastin e një ngjarjeje të zbuluar ose një kërcënimi për shëndetin publik. Mundësia e infektimit me sëmundje ngjitëse për qytetarët e BE-së/EEA-së gjatë Haxhit të vitit 2025 konsiderohet e ulët, për shkak të kërkesave të vaksinimit për udhëtimin në Mekë dhe Medinë dhe planeve të përgatitjes nga Arabia Saudite që adresojnë menaxhimin e rreziqeve shëndetësore para, gjatë dhe pas Haxhit. Rreziku i infeksionit konsiderohet i moderuar për njerëzit me sëmundje bashkëshoqëruese të moshuarit dhe gratë shtatzëna, me një probabilitet të ulët infeksioni dhe ndikim të moderuar. Ashtu si me ngjarjet e tjera të grumbullimit masiv, rreziku i shpërthimeve të sëmundjeve ngjitëse është më i lartë për sëmundjet e traktit respiratorë, gastrointestinal dhe të transmetuara nga vektorët.

Rreziku i sëmundjeve vaksinë parandaluese dhe të transmetuara nga vektorët konsiderohet i ulët nëse zbatohen masa parandaluese. Një rrezik i infeksionit dhe importimit të rasteve në Evropë pas Haxhit mbetet. Për pelegrinët që vizitojnë zonat e Haxhit dhe Umres në Arabinë Saudite, të cilët janë vaksinuar tashmë me vaksinën katërvalente kundër meningokokut, gjasat e infeksionit janë të ulëta, pasi janë të mbrojtura nga imuniteti i shkaktuar nga vaksina. Për pelegrinët e pavaksinuar, gjasat e infeksionit janë të moderuara.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË

PUBLIKE TË KOSOVËS

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000

WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>

E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net

Telefoni+38338 551432, ext. 1013



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS
NATIONAL INSTITUTE OF PUBLIC HEALTH OF KOSOVA